



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONIERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 8.3.2023

Nr: 148

Ora: 11:00

PROJEKTVENDIM

PËR

SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR REGJISTRIMIN E KOMITETIT NISMËTAR QË DO ORGANIZOJË PUNËN PËR PARAQITJEN E Z. LAZJON VANGJEL PETRI, SI KANDIDAT I PROPOZUAR NGA ZGJEDHËSIT NE ZONËN ZGJEDHORE BASHKIA KORÇË PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot më datë 8.3.2023 në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën me nr. 974 Prot., datë 20.2.2023 me:

Kërkues: 1-Nuçiel Ilia Doko, 2-Xhoana Agim Hoxhallari, 3-Iljon Kristaq Thanas, 4-Joan Vasillaq Koti, 5-Ema Myfit Muslli, 6- Ilir Piro Dimko, 7-Andonaq Ligor Nuni, 8-Arjan Nikollaq Kacimburo, 9-Arbër Ibrahim Gollobërda.

Objekti: Kërkohet regjistrimi i Komitetit Nismëtar, për paraqitjen e z. Lazjon Vangjel Petri, si kandidat i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore, Bashkia Korçë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Baza ligjore: Neni 70 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Në përfundim të shqyrtimit administrativ

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

Në referim të nenit 70, grupi i zgjedhësve i përbërë nga z. Nuçiel Ilia Doko, zj. Xhoana Agim Hoxhallari, z. Iljon Kristaq Thanas, z. Joan Vasillaq Koti, zj. Ema Myfit Muslli, z. Ilir Piro Dimko, z. Andonaq Ligor Nuni, z. Arjan Nikollaq Kacimburo dhe z. Arbër Ibrahim Gollobërda, është drejtuar KQZ-së me kërkesën me nr.974 Prot., datë 20.2.2023, për regjistrimin e Komitetit Nismëtar të formuar prej tyre.

Data: 8.3. 2023 Nr: 148
Ora: 11:00



“Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e Komitetit Nismëtar që do të organizojë punën për paraqitjen e z. Lazjon Vangjel Petri, kandidat i propozuar nga zgjedhësit Bashkia Korçë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”.

Kërkuesit kanë depozituar emrat dhe nënshkrimet e tyre si dhe i kanë bashkëlidhur kërkesës kopjet e dokumentave të identifikimit.

Nga verifikimi i emrave të kërkuesve në ekstratin e përbërësve zgjedhorë rezulton se janë zgjedhës të zonës zgjedhore Bashkia Korçë, dhe me vullnet të lirë kanë vendosur krijimin e Komitetit Nismëtar për organizimin e punës për mbledhjen e firmave mbështetëse për kandidatin z. Lazjon Vangjel Pjetri.

Kërkesa e paraqitur prej këtyre zgjedhësve, përmbush kriterin dhe afatin e përcaktuar në nenin 70, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1 shkronja “n”, e 2,dhe nenin 70, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar,

VENDOSA:

1. Regjistrimin e Komitetit Nismëtar që do të organizojë punën për paraqitjen e z. Lazjon Vangjel Petri, si kandidat i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore Bashkia Korçë, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda, 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij .

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI